



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 819/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesues, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevi anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Floretë Zejnullahu, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli i parashtruar nga Floretë Zejnullahu, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë me shenjën ZL.Anr.819/2017 e datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 09.11.2017, ka pranuar një apel nga Floretë Zejnullahu, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë e cila pretendon se i mungojnë votat e familjarëve dhe shoqërisë në vendvotimet me numër: 1809E/01R, 1812E/01R, 1812E/02R, 1812E/03R, 1814E/01, 1814E/03, 1841E/01, 1841e/02, 1825E/01.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimor, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ne apel të parashtrueses së apelit janë të pabazuara pasi që nuk ka ofruar asnjë dëshmi bindëse lidhur me pretendimet e parashtruara në apel.

Parashtimet në apel nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në qendrat e votimit të sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për apelinesin.

Paneli vlerësoi se pretendimet në apel nuk janë te bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 5.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.819/2017 më datën 12.11.2017.



Kryesuesja e Panelit
Gyltene Sylejmani

Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*